

Nr. 3678 Prot

Datë 26/09/2014

Nr. 25625 Prot

Datë 26/9/2014

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtitimit të Kredive” i ndryshuar, Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise” i ndryshuar, Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; si dhe akteve te tjera ligjore e nenligjore ne zbatim te tyre, Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve, (me poshte e quajtur DPT) e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm znj.Brisida SHEHAJ, dhe Agjencia e Trajtitimit të Kredive (më poshtë e quajtur ATK) e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z. Andi ÇOMOLLARI, te dyja te quajtura PALET, lidhin kete marreveshje bashkepunimi per sa vijon;

Neni 1**Rendesia**

ATK ne zbatim te Ligjin nr. 8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtitimit të Kredive” i ndryshuar ka per objekt veprimtarie të shërbejë si instrument i trajtimit të të gjitha pasurive në pronësi të saj te lindura nga transferimi i kredive nga bankat tregtare te nivelit të dytë me kapital tërësisht shtetëror.

AKT referuar ligjit organik u dërgon zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajteshme, drejtorive rajonale të shërbimit të transportit rrugor, zyrave të gjëndjes civile, ALUIZNI-t, organeve të pushtetit vendor, bankave të nivelit të dytë, fondacioneve kredi-dhënëse dhe institucioneve të tjera informacion për detyrimet, që persona të ndryshëm mund të kenë ndaj shtetit.

DPT ne zbatim te Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise” i ndryshuar, eshte autoriteti tatimor qendror i vetëm në Republikën e Shqipërisë, që zbaton dhe administron tatimet kombëtare ne pergjithesi si dhe institucioni qe do te mbledhe dhe administroje detyrimet tatimore te pashlyera ne vecanti;

DPT ka pergjegjesine e zbatimit dhe administrimit korrekt dhe me pergjegjesi te deklarimeve te te ardhurave te tatimpaguesve me qellim zbatimin e njëjtë dhe efektiv te legjislacionit tatimor per te gjithë tatimpaguesit;

Bashkepunimi institucional midis paleve, eshte i domosdoshem dhe i rendesishem pasi ndihmon ne zbatimin sa me korrekt te projekteve dhe detyrimeve qe rrjedhin nga zbatimi korrekt i ligjit dhe detyrimet funksionale, si dhe ndihmon ne vjeljen e detyrimeve te pashlyera te paleve nga debitorët e ndryshem, per llogari te buxhetit te shtetit.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është kordinimi i punës dhe detyrave funksionale të dy institucioneve në kuadër të evidentimit, llogaritjes dhe ndërmarrjes së hapave të nevojshme ligjore për vjeljen e detyrimeve të pashlyera që debitoret të ndryshëm kanë ndaj shtetit

Neni 3

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në respektim të të drejtave dhe detyrimeve të paleve përcaktuar në Ligjin themelues të shtetit dhe ligjet e tyre organike

- Kushtetuta e Shqipërisë
- Ligjin nr. 8894, datë 14.5.2002 “Për Agjencinë e Trajtimit të Kredive” i ndryshuar
- Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar
- Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;
- si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore në zbatim të tyre,

Neni 4

Menyra e realizimit

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje, ATK-ja i dërgon Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, listën me gjeneralitetet e shtetasve që kanë detyrime ndaj saj. Nga ana e Drejtorisë së Tatimeve evidentohen debitoret që janë subjekte tatimpagues duke vënë në dijeni për çdo rast ATK-në. Ky informacion shoqërohet edhe me statusin aktual të aktivitetit tregëtar të tatimpaguesit debitor (aktiv, pasiv, në procedurë likuidimi, falimentimi etj). Nepermjet informacionit të dërguar nga ATK, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve verifikon nëse debitoret e ATK janë gjithashtu edhe debitoret të saj, për të klasifikuar këta të fundit si subjekte debitore me risk të lartë. Palët marrin përsipër për vënien në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit, duke vënë në dijeni në mënyrë reciproke rastet e moszbatimit të saj nga organet e varesise së tyre. Për këtë qëllim ato angazhohen për të vënë në dijeni institucionet vartëse të tyre, me përmbajtjen e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi. Në zbatimin e kësaj marrëveshjeje palët kanë detyrimin ligjor të ruajtjes së kofidencialitetit të të dhënave që transmetohen.

Neni 5

Pikat e Kontaktit

Secila prej paleve do te caktoje nje person kontakti me qellim kordinimin e veprimeve per realizimin e marreveshjes

Neni 6

Ndashmeria e marreveshjes

Nese ndonje parashikim ne kete Marreveshje eshte i pavlefshem, i paligjshem ose i pazbatueshem, ky parashikim do te ndahet, dhe te gjitha parashikimet e kesaj Marreveshjeje do te mbeten plotesisht ne fuqi. Asnje parashikim i kesaj Marreveshjeje nuk eshte i varur nga ndonje tjeter parashikim pervecse ne rast se eshte shprehur ne kete Marreveshje.

Neni 7

Afati i marreveshjes

Kjo marreveshje lidhet per nje afat te pacaktuar Permbajtja e kesaj marreveshjeje mund te ndryshoje me pelqimin me shkrim te te dyja paleveKjo marreveshje mund te shfuqizohet me kerkesen e njeres pale, pas njoftimit paraprak me shkrim qe parashton edhe arsyet e prishjes se marreveshjes

Neni 8

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Mosmarrëveshjet midis palëve do të zgjidhen nëpërmjet negociimit dhe me mirëkuptim. Në rast se nuk arrihet zgjidhja në këtë mënyrë, marreveshja konsiderohet e përfunduar dhe e zgjidhur për të gjitha efektet.

Neni 9

Hyrja ne fuqi

Kjo marreveshje bashkepunimi u nenshkrua sot me date ____, ____, 2014 dhe hyn ne fuqi ne momentin e nenshkrimimit nga palet.

Marreveshja hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ANDI ÇOMOLLARI



DREJTOR I PËRGJITHSHËM

BRISIDA SHEHAJ

